




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01-381/14</u>
Nr. l faq. Broj stranica <u>02</u>	Data Datum <u>14.03.2014</u>
PRISTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 24 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 13.03.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-3963/13, për z. Kujtim Kërveshi – Anëtar i Këshillit Prokurorial të Kosovës, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik, nr. AKK – 03-3963/13, për z. Kujtim Kërveshi – Ndërmjetës në Republikën e Kosovës, dhe njëkohësisht trajner i ndërmjetësve në kuadër të Programit SEAD/USAID e më pas CLE\USAID, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Agjencia kundër Korrupsionit (më tutje Agjencia), pas pranimit të informatës për dyshimin e ekzistimit të konfliktit të interesit, ka filluar trajtimin e këtij rasti duke vërtetuar faktet dhe provat në dispozicion.

Në këtë rast, z. Kërveshi dyshohej për situatë të konfliktit të mundshëm të interesit në lidhje me funksionin e tij si ndërmjetësues dhe të qenurit paraprakisht trajner i ndërmjetësuesve.

Agjencia, si institucion i pavarur, që ndër të tjera bën mbikëqyrjen dhe parandalimin e rasteve që kanë të bëjnë me konfliktin e interesit si dhe ndërmerr masat e parapara ligjore (neni 5 paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 i Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit), pas trajtimit të

rastit, ka kontaktuar Ministrinë e Drejtësisë nga e cila ka marrë informata se z. Kërveshi, ka ofruar trajnimet për ndërmjetësues, si ekspert në kuadër të Programit SEAD/USAID fillimisht, e tani sipas Programit CLE/USAID, e që për Komisionin e Ndërmjetësimit konsiderohet se një gjë e tillë është në përputhje të plotë me Rregulloren për Trajnimin dhe Certifikimin e Ndërmjetësve.

Prandaj, duke pasur parasysh këto të dhëna, Agjencia, bazuar në nenin 18 (paragrafi 10) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, konstaton se, nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

Kjo bazuar në faktin se z. Kujtim Kërveshi, në këtë trajnim është angazhuar në kuadër të programeve të lartpërmendura të USAID, si njohës i mirë i kësaj fushe.

Kjo gjë është në përputhje me Rregulloren për Trajnimin dhe Certifikimin e Ndërmjetësve, përkatësisht nenin 9 (pika 2) të kësaj rregulloreje.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

